



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:209656
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699489

AA.nr.589/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Z.L, me vendbanim në Dragash, përfaqësuar nga Donat Hoti, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avdyl Bekteshi, përkitazi me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2388/2022, të datës;19.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, Z.L, me vendbanim në Dragash, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2388/2022, i datës;19.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2388/2022, të datës;19.07.2023, është vendosur, *“REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadi së paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit A.nr.441/2021 datë 07.09.2022, të të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.”*

Kundër aktgjykimit të lartpërmendur, me kohë ka paraqitur ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, Donat Hoti, avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim ose rivendosje, ose aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të anulohet akti administrativ i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 140, 194, 195, 200, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjen se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, me vendim me A.nr.441/2021, të dt.07.09.2022, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit me numër A.nr.441/2021, të datës;24.02.2021, dhe ka lënë në fuqi vendimin e datës;14.05.2021 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Dragashit.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktit administrative-njoftim të goditura me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Gjykata kishte parasysh Marrëveshjen Kolektive neni 52 ku përcaktohet:” 1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij;1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”, kurse në nenin 53 është përcaktuar se “I punësuari me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagën përcjellëse në lartësi prej tre (3) paga mujore që i ka marr për tre(3) muajt e fundit”. Me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës është e përcaktuar “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e ku arriti në përfundim se në këtë çështje juridike administrative duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye: paditësi i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 12.05.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, sipas vendimit datë 12.05.2018 dhe në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive pasi që marrëveshja është aplikuar në periudhën kohore nga data 01.01.2015-31.12.2017. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk mund të zbatohet për rastet tjera pas datës 31.12.2017. Në rastin e paditësit, nga shkresat e lëndës është jokontestuese fakti se paditësi ka dal në pension më datë 12.05.2018, pasi që ka pushuar së zbatuari Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive. Bazuar në vendimin nr.38/2015 referohet përvoja e punës e këtu paditësit 36 vite 21 ditë, kurse nga akte emërimi në shkresat e lëndës këtu paditësi ka themeluar marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me datës 01.01.2012, andaj edhe mbi këtë bazën e arritjes së periudhës së viti jubilar kërkesa nuk referohet bazuar në afatin tre vjeçar nga momenti i kalimit të një muaji nga lindja e kërkesë dhe po ashtu viti jubilar është arritur kur marrëveshja kolektive nuk ka fuqi juridike, kjo për faktin se përvoja e referuar sipas vendimit 38/2015 përshkruhet për periudhën 03.07.1972 - 07.08.1972, 01.09.1972, 01.09.1978 - 30.04.1993, 15.04.1996, 24.06.1999, 25.06.1999-01.10.2002, andaj Gjykata refuzoi kërkesën e paditësit pasi Gjykata gjeti se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga*

01.01.2015 dhe në nenin 52 dhe 53 të kësaj marrëveshje është paraparë shpërblimi jubilar dhe pagat përcjellëse, ndërsa paditësi ka iniciuar kërkesën në kohën kur Marrëveshja kolektive nuk ka qenë më në fuqi. Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e paditësit se i takon e drejta e tri pagave jubilarë dhe atyre përcjellëse dhe ka konstatuar se të njëjtat janë të pabazuara për faktin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk ishte në fuqi në kohën e pensionimit të këtu paditësit për këto arsye nuk u gjet një bazë për ti aprovuar pretendimet e paditësit si të bazuara dhe për të njohur të drejtën e kërkuar.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje të dispozitave të LKA-së, kolegji i apelit vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, ngase e paditësi të njëjtave shkelje iu ka referuar si shkelje të LPK-së, duke specifikuar se shkeljet esenciale qëndrojnë për shkak se dispozitivi është i pa qartë, konfuz dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës dhe arsyetimin e aktgjykimit, megjithatë kolegji i apelit vëren se gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të objektit të kërkesëpadisë së paditësit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Lidhur me pretendimin ankimor për vërtetimin e gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, se “Të drejtat e paditësit i rrjedhin nga Kontrata Kolektive, neni 52 dhe 53, meqenëse të drejtat paditësit i kanë lindur gjatë periudhës sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive e pasi që kërkesa ka të bëjë me të holla dhe kërkesat në të holla parashkruhen për tri vite, paditësi brenda afatit të përcaktuar për këtë të drejtë subjektive të tij ka parashtruar këtë padi dhe gjykata e shkallës së parë përkundër afatshmërisë së kërkesës brenda afatit 3 vjeçar sipas Ligjit të Punës e abstrahon këtë çështje duke konkluduar se paditësi ka ushtruar kërkesën pasi që më nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive...”. Mirëpo kolegji i apelit vlerëson se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, kur ka vlerësuar se “Gjykata kishte parasysh Marrëveshjen Kolektive neni 52 ku përcaktohet:” 1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”, kurse në nenin 53 është përcaktuar se “I punësuar me rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagën përcjellëse në lartësi prej tre (3) paga mujore që i ka marr për tre(3) muajt e fundit”. Me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës është e përcaktuar “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e ku arriti në përfundim se në këtë çështje juridike administrative duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye: paditësi i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datë 12.05.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, sipas vendimit datë 12.05.2018 dhe në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive pasi që marrëveshja është aplikuar në periudhën kohore nga data 01.01.2015-31.12.2017. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk mund të zbatohet për rastet tjera pas datës 31.12.2017. Në rastin e paditësit, nga shkresat e lëndës është jokontestuese fakti se paditësi ka dal në pension më datë 12.05.2018, pasi që ka pushuar së zbatuari Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive. Bazuar në vendimin nr.38/2015 referohet përvoja e punës e këtu paditësit 36 vite 21 ditë, kurse nga akte emërimi në shkresat e lëndës këtu paditësi ka themeluar marrëdhënie pune pranë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me datës 01.01.2012, andaj edhe mbi këtë bazën e arritjes së periudhës së viti jubilar kërkesa nuk referohet bazuar në afatin tre vjeçar nga momenti i kalimit të një muaji nga lindja e kërkesë dhe po ashtu viti jubilar është arritur kur marrëveshja kolektive nuk ka fuqi juridike, kjo për faktin se përvoja e referuar sipas vendimit 38/2015 përshkruhet për periudhën 03.07.1972-7.08.1972, 01.09.1972, 01.09.1978-30.04.1993, 15.04.1996, 24.06.1999, 25.06.1999-01.10.2002, andaj Gjykata refuzoi kërkesën e paditësit pasi Gjykata gjeti se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga 01.01.2015 dhe në nenin 52 dhe 53 të kësaj marrëveshje është paraparë shpërblimi jubilar dhe pagat përcjellëse, ndërsa paditësi ka iniciuar kërkesën në kohën kur Marrëveshja kolektive nuk ka qenë më në fuqi”.

Në këtë kuptim sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe jo Ligjin e Punës, për faktin se në nenin 52 dhe 53 të Kontratës Kolektive janë përcaktuar shpërblimet jubilar dhe kompensimi në rast të pensionimit, kur ka gjetur se këtu paditësi ka iniciuar kërkesën në kohën kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk ka qenë më në fuqi.

Prandaj, në bazë të provave të administruara në procedurë si dhe dispozitave ligjore të lartcekura, Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative nga ana e të paditurit drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara nuk ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale janë vërtetuar plotësisht e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë vendim i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, në këtë kuptim ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimit u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
AA.nr.589/2023, datë;13.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Hajriz Hoti